



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KALENDARI ARTISTIK



NËNTOR
2023

“VIZITA”

Shfaqje teatrore
Teatri “Migjeni”, Teatro Sardegna, Instituti Italian i Kulturës (Tiranë), Teatri Kombëtar

Data: 01-02.11.2023

Ora: 19:00

Vendi: Salla “Central 400”,
Teatri Kombëtar, “ArTurbina”

“Vizita” është mbështetur në kryeveprën e H.G. Wells “Vizita e mrekullueshme”, një pararendës vizionar i zhanreve dhe gjuhëve, duke e zhvendosur gjithsesi boshtin e interesit të tij nga satira karshi konformizmit viktorian, drejt një kritike më bashkëkohore. Vjen në skenë për herë të parë nga Davide Iodice, një nga regjisorët më të suksesshëm të teatrit bashkëkohor.



një shfaqje nga Davide Iodice



Teatro Sardegna
OJET

vizita

Me Datë 27, 28, 29 Tetor
Ora 19:00
Tek Teatri “Migjeni”, Shkodër

Me datë 1 dhe 2 Nëntor
Ora 19:00
Tek salla “Central 400”
ArtTurbina, Tiranë

Nga “Vizita e mrekullueshme” me autor H.G. Wells

Teksti: Fabio Pivano
Përkthimi: Zija Yaka
Përkthimja, Kostumet, Skenografia dhe Regjia: Davide Iodice
Muzika origjinale: Leo Cammaroscio
Dritat: Lolo Franciosi Hamelin
Konstruksionet Skenografike: Dymi Guçita
Ndihmës i Regjisë: Jozef Shiroka
Prodhimi: Teatri Migjeni, Teatro Sardegna Teatro dhe me mbështetjen e Institutit Italian të Kulturës në Tiranë
Sipërmartë: Danilo Sobolev
Inspektor skenë: Mikel Vukani
Drimi dhe parakurja: Albert Shiroka
Fotot: Sedi Doci
Teknikë ndihmëse: Arben Meshuni, Eniko Masi
Prodhuesit: Alexcia nebojca

Regjitor kostumesh: Leonard Daga
Teknikë skenë: Artan Çanga, Mark Ujka, Marko Prendi
Rekuzitë: Arjan Lishi
Foto: Eniko Masi
Figura e Engjëllit u krijua nga: Chicca Ruocco
Interpretimë sipas radhës së hyrjes në skenë:
Nelson Fakela – Ishari
Rajmonda Marko – Nena / narratori / fshati
Pavlin Vasa – Priti
Fritz Selman – Engjëlli
Rita Orlina Kacaroni – Zoda e shqipërisë / narratori / fshati
Julinda Emir – Dalia / narratori / fshati
Jozef Shiroka – Mëkë / fshati
Marta Sima – Zonja / fshati
Aleksander Pranga – Ushtri / narratori / fshati
Vedimi Doda – Tshatori / Zoti Doci / fshati

Me bashkëpunim dhe kontributin e



“E KUQE E ERRËT”

Projekt i Fondit të Teatrit për të Rinj
Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”

Data: 02– 04.11.2023

Ora: 19:00

Vendi: Teatri “A.Z. Çajupi”, Korçë
Regjia: Mariel Brahimllari

“E kuqe e errët” është një kërkim artistik në zhanrin e dans-teatrit, frymëzuar nga novela e famshme e Migjenit “Historia e njenës nga ato”.

Në Shqipërinë e Migjenit, Lukja ishte një rast i izoluar, ndërsa sot si Lukja ka shumë dhe të gjitha po ndjekin rrugën e saj për të arritur aty ku duan.

Lukeizimi i femrës moderne shqiptare ka sjellë fenomenin e përdorjes së trupit për të arritur çdo qëllim të dëshiruar: një vend pune, jetën luksoze, famën e shpejtë apo pasurimin.

Ky kërkim synon të sjellë në vëmendjen e publikut jo vetëm prostitucionin në kuptimin

klasik të fjalës, në atë të shkëmbimit të trupit për para, por në çdo formë tjetër të tij, kur favori seksual shkurton rrugën drejt karrierës apo pasurisë.

“Me siguri do njihni ndonjenën nga motrat legjitime të Lukes, asht njësoj si me njoftë Luken vetë. Jeta e tyre asht një. Të gjitha janë njësoj dhe të gjitha ju apin atë që kërkoni - me pare në dorë. “ - Historia e njenës nga ato, Migjeni.

“KUSH FOLI?”

Ventrilokuiste Show, Arjeta Dhima

Data: 03.11.2023

Ora: 19:00

Vendi: Salla “Central 400”, Teatri Kombëtar, “ArTurbina”

Kukullat në duart e Arjeta Dhimës nuk janë lodra dhe teatër kalamajsh, por personazhe që Arjeta u jep jetë me zërin e saj; personazhe që jo vetëm të vdesin gazit duke prodhuar humor mbi atë ç’ka ne jetojmë përditë, por edhe të shkundin nëpërmjet mesazheve të forta.



“M’I GJENI KËNGËT E RINISË”

Produksion i Fondit të Teatrit për të Rinj

Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”

Data: 04–05.11.2023; 10–12.11.2023

Ora: 19:00

Vendi: Teatri “Skampa”, Elbasan

Regjia Ina Morinaj

Shfaqja “M’i gjeni këngët e rinisë” është frymëzuar nga vepra e plotë e Millosh Gjergj Nikollës (Migjenit). Personazhet sjellin përpara publikut histori të ndryshme. Studenti emigrant rikthehet në një shtëpi që tashmë i duket e huaj. Ai duhet të përballet me nostalgjinë për jetën që la pas dhe realitetin mbytës të vendit të tij. Njerëzit që gjen në shtëpi janë po të njëjtët, por atij i duken më të largët se kurrë. Ndërkohë, merr vesh dhe një lajm - e motra do të martohet.

Historia e dytë është ajo e një 30-vjeçari që ndihet tashmë i plakur. Jeta për të ndryshon me ritme të shpejta dhe tashmë i duket sikur nuk ka më fuqi



e mbështetje për asgjë. Dëshirat që ka janë të papërshtatshme për kohën - dashuria romantike, shtëpitë e vjetra janë tashmë të dala mode.

Historia e fundit trajton se si të rinjtë gjithmonë e më tepër e ndiejnë se si humbasin shpresën në vendin ku jetojnë. Për ta rrugëdalja e vetme është largimi, por me kokën gjithmonë mbrapa.

“ATA HYJNË PA TROKITUR”

Data: 09, 10, 11, 12, 16, 17, 18, 19. 11. 2023

Ora: 19:00

Vendi: Teatri Metropol - Qendra Kulturore Tiranë

Autor dhe regji: Armand Bora

Interpretojnë: Herion Mustafaraj, Era Makoçi

Në thellësi të frikës dhe vetanalizës, “Ata hyjnë pa trokitur” rrëfen për një çift intelektualësh të cilët presin me ankth arrestimin nga sigurimi i shtetit. Të ngujuar në apartamentin e tyre, me valixhe të paketuara, ata presin për atë trokitje fatale. Përmes introspektivës së tyre, apartamenti kthehet në një dhomë hetimi, ku ata bëhen hetues të njëri-tjetrit. Ky nuk është rrëfim i heronjve, por i individëve të zakonshëm, që dëshira e tyre për një jetë të qetë prishet nga forcat e kontrollit. Në fund, në kërkim të dëshpëruar për ndihmë, përballen me heshtjen e rëndë, duke u përballur me një zbulim tronditës mbi njerëzimin. Një histori e fuqishme që jehon me provat e ndërjegjes njerëzore nën hijen e shtypjes.

Merrni biletat tuaja TANI!

Për informacione dhe rezervime:

+355 67 227 0668



“NEVER TWENTY-ONE”

ADMC dhe Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”

Data: 12.11.2023

Ora: 19:00

Vendi: Salla 150, Arturbina Tiranë

Kohëzgjatja: 60 min

“Një vepër që ecën krah për krah me vdekjen nuk është ndier kurrë kaq vitale dhe e gjallë.” - Karina Buckley, Revista SpringBack, frymëzuar nga hashtag-u #Never21 i lëvizjes Black Lives Matter, pjesa thellësisht tingëlluese e koreografit dhe balerinit francezo-malian Smaïl Kanouté - duke bërë premierën e saj në SHBA - u bën homazh

të rinjve me ngjyrë që kanë humbur jetën nga dhuna me armë në të gjithë botën para se të arrijnë në moshën 21 vjeç. Performanca, e ndarë në tri segmente, fokusohet në vdekjet e pakuptimta të të rinjve me ngjyrë në Nju Jork, Johaneshburg dhe Rio de Zha-neiro. Fragmente të dëshmimeve të fuqishme nga familjarët e viktimave janë transkriptuar në trupat e kërcimtarëve, duke ndërthurur kërcimin dhe artin pamor. Lëvizja intensive e kërcimtarëve bazohet në kërcimin bashkëkohor dhe intuitiv, krump, popping dhe baile funk në rrëfimin e historive të shumë jetëve të thyera. Koreografi Smaïl Kanouté, interpretuar nga Smaïl Kanouté, Aston Bonaparte dhe Salomon Mpondo-Dicka, bashkëprezantuar me New York Live Arts dhe Villa Albertine, si pjesë e sezonit Albertine Dance.

“E KUQJA”

Premierë

Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”

Data: 16–19.11.2023; 29- 30.11.2023

Ora: 19:00

Vendi: Salla 150, Arturbina, Tiranë

Regjia: Altin Basha

Aktorë: Gentian Zenelaj, Urim Aliaj

“E kuqja” është një shfaqje me dy personazhe, nga shkrimtari amerikan John Logan për artistin Mark Rothko. U prodhua për herë të parë nga ‘Donmar Warehouse’, Londër, më 8 dhjetor 2009, nga Michael Grandage. Më pas u transferua në Broadway, në mars 2010, me të njëjtat personazhe kryesore, Alfred Molina dhe Eddie Redmayne, ku fitoi shumë çmime Tony. Vepra është shfaqur më pas në shumë vende anembanë botës, me një rivënie të vitit 2018 në Londër, me regji të Grandage, ku dhe Molina përsëriti rolin e tij origjinal si Rothko.

“Vetëm një gjë kam frikë në jetë, miku im... Një ditë e zeza do ta përpijë të kuqen”.

Mark Rothko është në studion e tij në Nju Jork, në vitet 1958/59, pasi është porositur të pikturojë një grup muralesh për restorantin e shtrenjtë dhe ekskluziv ‘Four Seasons’. Ai i jep urdhra ndihmësit të tij, Kenit, ndërsa Keni përzien bojërat, bën kornizat dhe përgatit pikturat. Keni, megjithatë, përfundimisht vë në dyshim teorinë e artit të Rothkos dhe pranimin e tij për të punuar në një projekt të tillë tregtar. Nga ana e tij, Rothkos nuk i pëlqen ngritja e artit pop.

Në fund, Rothkoja e ndërpret punën në projekt dhe vendos të kthejë paratë. Ai i shpjegon Kenit se ‘Four Seasons’ është një vend i papërshtatshëm për të parë muralet e tij.

FESTIVALI I TEATRIT SHQIP “MOISIU”

Aktivitet i organizuar nga Teatri Kombëtar, në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Kosovës dhe Teatrin Shqiptar të Shkupit.

Data: 20–27.11.2023

Ora: 19:00

Vendi: Teatri Kombëtar, Salla 400, Arturbina Tiranë
Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, Salla 150, Arturbina Tiranë
Salla e Teatrit Metropol

Ky edicion do të zhvillohet në Tiranë mes datave 20-27 nëntor 2023, duke paraprirë në mënyrë simbolike edhe ‘Festat e Nëntorit’. Pjesëmarrës në Festival do të jenë 14 produksione nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia, të cilat konkurrojnë mes tyre për çmime artistike në kategoritë e ndryshme.

“IKJA”

Produksion i Fondit të Teatrit për të Rinj
Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”

Data: 23– 25.11.2023

Ora: 19:00

Vendi: Teatri “Migjeni” Shkodër

Data: 28- 29.11.2023

Ora: 19:00

Vendi: Qendra Arka, Shkodër

Regjisor: Rafael Hoxha

“GADJO”

Festivali i Teatrit Shqip “Moisiu”

Data: 26.11.2023

Ora: 19:00

Vendi: Salla 150, Arturbina, Tiranë

Dramë nga Jeton Neziraj

Regjia: Blerta Neziraj

Aktorë: Edona Reshitaj, Juli Emiri, Verona Koxha, Rafael Hoxhaj, Blend Sadiku

Kompozitor: Jindrich Cizek

Kostumograf: Blagoj Micevski

Koncepti vizual dhe skena: Mentor Berisha

Realizimi i scenografisë: Beqo Nanaj

Dritat: Yann Perregaux, Mursel Bekteshi

Teknik i dritave dhe i ndriçimit: Taulant Kotorri.



“ÇIFTI I SHQYER”

Shfaqje teatrore (komedi)

Data: 28.11.2023- 30.11.2023

Ora: 19:00

Vendi: TKOBAP, Holli

“WEDNESDAY IN JAZZ”

Koncert instrumental

Data: 01.11.2023

Ora: 20:00

Vendi: TKOBAP, Holli Koncertor

Një event unik që ndodh për herë të parë. TKOB në bashkëpunim me Konservatorin e Potenzës sjell në Tiranë një ditë të çdo jave një grup të ndryshëm, që interpretojnë muzikë Jazz. Një mbrëmje e veçantë për gjithë të interesuarit.

“IN MEMORIAM”

Koncert simfonik

Data: 02.11.2023

Ora 19:00

Vendi: Skenë, TKOBAP

Orkestra e TKOB-it do të interpretojë veprat e kompozitorëve të cilët kanë lënë gjurmë në krijimtarinë shqiptare si S. Gjoni, Dh. Leka dhe N.Zoraqi. Dirigjent: Edmond Doko



“STABAT MATER”

Koncert simfonik

TKOB në bashkëpunim me JKN
Kryevepra absolute e Rossini-t

Data: 07.11.2023

Ora: 19:00

Vendi: Skenë, TKOBAP



“WEDNESDAY IN JAZZ”

Koncert instrumental

Data: 08.11.2023

Ora: 20:00

Vendi: TKOBAP, Holli koncertor

Data: 16.11.2023

Ora: 17:00

Vendi: TKOBAP, Holli Koncertor

Data: 22.11.2023

Ora: 20:00

Vendi: TKOBAP, Holli Koncertor

Data: 29.11.2023

Ora: 20:00

Vendi: TKOBAP, skenë

Një event unik i cili ndodh për herë të parë. TKOB në bashkëpunim me Konservatorin e Potezës sjell në Tiranë një ditë të çdo jave një grup të ndryshëm, që interpretojnë muzikë Jazz.

“ATTILA”

Opera premiere absolute

Data: 15, 16, 18, 19.11.2023

Ora: 19:00

Vendi: TKOBAP, Skenë

Attila është një opera nga Giuseppe Verdi, me libret nga Temistocle Solera. Tema është marrë nga tragjedia “Attila, König der Hunnen e Z. Werner. Premiera absolute e veprës u zhvillua më 17 mars 1846, në Teatro La Fenice, në Venecia.

PROLOG:

Në Aquileia rreth mesit të shek.V Odabella, vajza e të zotit të qytetit, ka humbur të gjithë familjen e saj pas plaçkitjes së hunëve dhe synon të hakmerret ndaj Attilës, duke e vrarë atë. Gjenerali romak Ezio, i vetëdijshëm për dobësinë e perandorit të tij, i ofron Attilës një aleancë për sa kohë që Italia është e sigurt; por Attila e refuzon me përbuzje.

AKTI I PARË

Ndërsa hunët, pasi kanë mbërritur në portat e Romës, përgatiten për ta pushtuar atë, Odabella në një rrëfim të brendshëm për humbjen e babait të saj, më pas ribashkohet me të dashurin e saj, Foreston, dhe e informon atë për planin e saj për hakmarrje. Ndërkohë Attila, tashmë i shqetësuar nga një ëndërr, takohet me Leonen, e nxiton ta takojë atë me gjithë popullsinë e qytetit dhe heq dorë nga pushtimi dhe plaçkitja e Romës.

AKTI I DYTË

Attila shtron një banket për nder të Ezios, i cili i propozon përsëri një aleancë. Odabella, pasi mësoi se ata po komplotojnë për të helmuar mbretin, e paralajmëron atë; jo për ta shpëtuar, por për ta vlarë vetë më vonë. Foresto rrëfen, por Attila e fal dhe, i goditur nga gjesti i Odabella për të cilin ai beson se është bujar, njofton martesën e tij me të. Më pas ai ndahet nga Ezio, duke e siguruar se nuk do ta pushtojë kurrë Romën.

AKTI I TRETË

Attila përballet me Ezion, Foreston dhe Odabellan; duke ndier se duan ta vrasin, ai kujton gjeneralit se ka shpëtuar Romën, Foreston, faljen e marrë dhe Odabelën, se dëshiron të martohet me të; por gabimet dhe krimet e tij janë shumë për t'u falur. Odabella godet me thikë mbretin për vdekje, ndërsa romakët luftojnë me barbarët. Solistet kori dhe Orkestra Simfonike e TKOB-it në bashkëpunim me Konservatorin “Umberto Giordano”, Foggia dhe Konservatorin “Giuseppe Martucci”, Salerno



Dirigjent: Jacopo Sipari di Pescasseroli
Regjisor: Ada Gurra

“SIMFONITË E SHPIRTIT”

Data: 25.11.2023

Ora: 19:00

Vendi: TKOBAP, Skenë

Koncert instrumental-simfonik, me vepra të dy kompozitorëve shqiptarë, secili përfaqësuesi i denjë i epokës së tij: Feim Ibrahimi, reformatori i muzikës shqiptare dhe Aleksandër Peçi, kompozitori më kontemporan i saj.

Orkestra Simfonike e TKOB-it në bashkëpunim me Konservatorin “Umberto Giordano”, Foggia

Solistët dhe kori i TKOB

Dirigjent: Jacopo Sipari

“E BUKURA MORE”

Etno-muzikal

Data: 28.11.2023

Ora: 19:00

Vendi: TKOBAP, Skenë

“E bukura more”, kështu i kanë thënë Shqipërisë prej shekujsh të parët, kështu na pëlqen t’i themi asaj, të bukurës edhe sot..... Ky etno-muzikal përshkon nëpërmjet riteve, zakoneve, këngëve, valleve, veshjeve gjithë hapësirën shpirtërore të shqiptareve, duke krijuar një histori unike. Një këndvështrim i ri artistik dhe origjinal, bazuar mbi motivet e folklorit popullor, sjellë në skenë me një koncept bashkëkohor të gjuhës muzikore. Pjesëmarrës, trupa e Ansambllit Popullor dhe artistë të ftuar.

Muzika&Libreti: Sokol Marsi

“FOLK FEST 2023”

Data: 28.11.2023

Ora: 19:00

Vendi: Sheshi “Skënderbej”

Me rastin e 111-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, më 28 Nëntor 2023, në sheshin “Skënderbej” në Tiranë, në orën 19.00, do të zhvillohet koncerti i madh festiv “Folk Fest 2023”. Koncerti, i cili zhvillohet nën kujdesin e veçantë të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Z. Edi Rama, do të risjellë në skenë, me gjithë larminë dhe ngjyrat e saj, një pjesë të repertorit më të mirë të Festivalit Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës. E gjithë Tirana do të gjallojë nga festa. Në çdo shesh do të ketë performanca artistike, që do të kulmojnë në Sheshin “Skënderbej”, në mbrëmje.

“QUEER FILM MARATHON”

Fondacionit Heinrich Böll Stiftung

Data: 01-04.11.2023

Ora: 18:00

Vendi: Salla 150, Arturbina Tiranë

Një festival për filmat që refuzojnë të jenë të padukshëm dhe tregojnë me guxim histori që krijojnë hapësirë të re kulturore.

BUONENUOVE: WOMEN CHANGING ARCHITECTURE

Ekspozitë

Nuk e keni vizituar ekspozitën BUONEN-
UOVE: Women Changing Architecture

Nuk ka problem, jeni ende kohë për ta bërë!

Ekspozita ju pret te kubi U9 i Piramidës së
Tiranës dhe do të vazhdojë të qëndrojë e ha-
pur për publikun deri më 20 nëntor 2023.

Hyrja e lirë nga e marta deri të dielën, nga ora
10.00 deri në orën 18.00.



“VISHEMI ME TRADITË”

Ekspozitë

Data e hapjes: 04.11.2023

Ekspozita do të qëndrojë e hapur deri në orën 17:00.

Vendi: Muzeu i Gruas, Rruga “Myslym Shyri” 4, Tiranë

Shoqata “Together for Life” në partneritet me Muzeun e Gruas do të prezantojnë
një koleksion të veçantë të veshjeve dhe aksesoreve, të krijuar nga stilistët e reja,
frymëzuar nga trashëgimia e pasur kulturore shqiptare.

Ekspozita do të jetë e konceptuar si një udhëtim nëpër kohë, ku estetika e lashtë
takon inovacionin dhe kreativitetin modern.

Bashkohuni për të shijuar dhe vlerësuar artin dhe kulturën tonë autentike, të
shprehur përmes stilit dhe elegancës së veshjeve dhe aksesoreve modernë të
frymëzuar nga tradicionalja.

SHFAQJE NË KINEMA

Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit

“SHOKU YNË TILI”

Data: 07.11.2023

Ora: 11:00 - 13:00

“Kryekënga e kombit”

Data: 10 .11.2023

Ora: 10:00 - 12:00

Historia e himnit të flamurit. Si lindi, si u kompozua e si udhëtoi në Shqipëri nga Bukureshti. Dokumentar i prodhuar në vitin 2012 nga BunkerFilm.

“APASIONATA”

Data: 14.11.2023

Ora: 11:00 - 13:00

Vepra e regjisorit Ibrahim Muçaj dhe Kristaq Mitro tregon historinë e një pianisteje dhe një studenti të artit.

“NUSJA DHE SHTETRRETHIMI”

Data: 16.11.2023

Ora: 11:00 - 13:00

Shfaqje me rastin e 45-vjetorit të premierës. Premiera e parë e filmit u mbajt në Tiranë, më 16/11/1978.

“RADIOSTACIONI”

Data: 17.11.2023

Ora: 11:00 - 13:00

Shfaqje me rastin e 79-vjetorit të Çlirimit të Tiranës. Me regji nga regjisori Rikard Ljarja.

“LIRI A VDEKJE”

Data: 20.11.2023

Ora: 11:00 - 13:00

Shfaqje me rastin e Festave të Nëntorit. Me regji të kineastëve Ibrahim Muçaj dhe Kristaq Mitro, kjo dramë me ngjyra ju fut thellë në histori.

“TOMKA DHE SHOKËT E TIJ”

Data: 22.11.2023

Ora: 11:00 - 13:00

Shfaqje me rastin e 46-vjetorit të premierës. Premiera e këtij filmi u mbajt më 22/11/1977. Me regji të regjisores Xhanfise Keko.

“KTHIMI I USHTRISË SË VDEKUR”

Data: 24.11.2023

Ora: 11:00 - 13:00

Shfaqet në përkujtim të Luftës II Botërore dhe plot 34 vite pas premierës.

“GJURMË NË KALTËRSI”

Data: 27.11.2023

Ora: 11:00 - 13:00

Shfaqje në përkujtim të ditëlindjes së aktorit Xhevdet Feri (26.11.1960 - 16.01.2020). Me regji të Samir Kumbaros.

“NËNTORI I DYTË”

Data: 28.11.2023

Ora: 11:00 - 13:00

Shfaqja mbahet me rastin e festimeve të ditës së Pavarësisë së Shqipërisë dhe 41 vite pas premierës.

“PËRRALLË NGA E KALUARA”

Data: 30.11.2023

Ora: 11:00 - 13:00

Shfaqje e versionit të restauruar, për të urrear ditëlindjen e aktores Elvira Diamanti (30/11/1962). Komedia me ngjyra e regjisorit Dhimitër Anagnosti. Vendi: Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit Rruga Aleksandër Moisiu, 76/1, Tiranë, Albania


“FAKSIMILE”

Ekspozitë
Helidon Haliti

Data e hapjes: 06.11.2023

Ora: 18.00

Vendi: Galeria FAB / Universiteti i Arteve



“Faksimile” është një koncept që ka zënë fill nga bisedat e autorit me poetin Faslli Haliti, i cili është edhe babai i tij. Ja si e shpjegon autori: “Njeriu që më ka krijuar fizikisht, por edhe më ka mburrur shpirtërisht dhe artistikisht. Ne kemi pasur një ëndërr të përbashkët: Që babai të kuronte një ekspozitë timen, me një koncept fare të thjeshtë, për të vënë në dukje faktin se në të gjitha pikturat e mia gjen pjesë nga lirikat e poezisë së tij, nga shqetësimet e tij sociale dhe altruizmi i padiskutueshëm i tij si njeri. Por, Faslli Haliti u nda nga jeta tre vjet më parë dhe ky koncept po bëhet realitet vetëm tani. Ekspozita është e përbërë prej copëzash kujtimesh, të cilat unë i quaj “Faksimile”. Janë copëza poezish, figurash - edhe figura të plota, pse jo - copëza shqetësimesh sociale dhe zhvillimesh që kanë ndodhur pas ndarjes nga jeta të babait tim për shkak të Covid-19. Kjo ekspozitë vjen si një plotësim i filozofisë se

arti shtegton edhe pa krijuesin, për të thënë se shpirti nuk humbet asnjëherë dhe se komunikimi ynë vijon ende përmes ëndrrash e vargjesh poetike, në një bisedë, e cila zhvillohet prej më shumë se 55 vjetësh, edhe pas vdekjes së tij. Poezitë e tij janë si tituj të pikturave të mia, kurse ekspozita është e thurur me përrallat që më ka treguar kur isha fëmijë.

Ekspozita ka marrë formën e saj dhe do të hapet për publikun në 6 nëntor, ora 18:00. Ajo përmban rreth 40 punime në pikturë, kryesisht kompozim, por të shoqëruara me një peizazh onirik, ku janë të pranishme edhe vitet e fëmijërisë, tingujt e së kaluarës, të ndërthurura fort edhe nga e tashmja. Ekspozita ka shqetësime të botës, si për të thënë se historitë përsëriten, por gabimet dhe fajet nuk duhet në asnjë mënyrë të bien në prehrin e përsëritjes.

Pikturat rrëfejnë për shqetësimin e një armiku, dikur të padukshëm, si Covid-19, dhe të një konflikti të tanishëm me dilemat e artistit, por edhe me pështjellimet e një qytetari, dikur fëmijë, sot piktor, për të thënë se shqetësimet e prindit kuptohen vetëm në momentin kur bëhesh prind vetë, ndërsa burri plotësohet në çastin kur humbet krijuesin e tij.

Punimet nuk largohen nga ngjyrimet personale të miat dhe shpeshherë shoqërohen nga lirizmi dhe klithmat e poezive të poetit Faslli Haliti.

Në tre sallat e ekspozitës publiku do të shohë një minimuze, ku dimensionin do të jetë i larmishëm, shqetësimet do të shfaqen lakuriq, siç janë, përpara tij, por pa u konkretizuar në një portret të caktuar. Ekspozita është konceptuar si një lloj instalacioni, i cili e ka nisur rrugëtimin e tij para 4 vitesh, dhe sot është i gatshëm për t'u përballur dhe bashkëbiseduar me publikun, për të kuptuar se shpirti vijon".

“RRUGËTIMI I SHQIPËRISË NË KOMUNIZËM”

Ekspozitë

Data: 29.11.2023-07.12.2023

Ora: 10:00

Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe”

Ekspozitë me rastin e Çlirimit të Shqipërisë dhe rrugëtimin autoritarist që mori vendi në periudhën 1944-1991

“DIKTATURA NË PËRDITSHMËRI: OBJEKTE QË RRËFEJNË”

Ekspozitë

Data: 15.11.2023 -15.12.2023

Vendi: Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe”

Ekspozitë me objekte dhe rrëfime, në bashkëpunim me Arkivin Qendror të Shtetit, mbështetur nga Balkan Museum Network

9.11.2023 — Vernissage 18:00



“FIJE PËR FIJE”-”THREAD BY THREAD”

Armando Lulaj, Endri Dani, Lori Lako, Matilda Odobashi, Pleurad Xhafa dhe Redina Qose.

Data: 09-25.11.2023

Ora: 18:00

Vendi: ZETA Contemporary Art Center

Me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, 6 artistë bashkëkohorë do të jenë pjesë e një aktiviteti që lidh bashkëkohoren me traditën. Studiot e artistëve do të zëvendësohen me hapësirat e artizanëve që realizojnë qilima. Ky projekt fokusohet në një debat të vjetër mbi artin dhe zejen, duke krijuar një dialog mes dy sferave.

“EKSPOZITË ME RASTIN E 28 NËNTORIT, DITËS SË PAVARËSISË”

Data: 24.11.2023 – 04.12.2023

Vendi: Holli Kryesor - Muzeu Historik Kombëtar

Ekspozita do të përmbajë materiale të cilat kanë të bëjnë me rrugëtimin drejt ngritjes së flamurit, fotografi të firmëtarëve, ngritjen e flamurit etj.

“KUJTOJMË PËR TË MOS HARRUAR”

Program edukativ me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, të cilat vizitojnë muzeun “Shtëpia me gjethe”, i vendosur në një nga objektet që shërbenin për ish-Sigurimin e Shtetit. Këto vizita shoqërohen me takime me ish-të persekutuar të regjimit komunist, të cilët ndajnë historinë e tyre me të rinjtë, në mënyrë që ata të mësojnë për të shkuarën jo shumë të largët në Shqipëri.

Programi:

SHKOLLA E MESME “ISMAIL QEMALI”

Data: 02.11.2023

Ora: 10:00

SHKOLLA E MESME “BESNIK SYKJA”

Data: 09.11.2023

Ora: 10:00

SHKOLLA E MESME “PETRO NINI LUARASI”

Data: 16.11.2023

Ora: 10:00

SHKOLLA 9-VJEÇARE “FAN NOLI”

Data: 24.11.2023

Ora: 11:00

SHKOLLA 9-VJEÇARE “EQREM ÇABEJ”

Data: 30.11.2023

Ora: 10:00

Vendi: Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe”



“MBRESA”

Program edukativ me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, të cilat vizitojnë muzeun “Shtëpia me gjethe”. Këto vizita shoqërohen me takime ku vetë të rinjtë ndajnë copëza rrëfimesh nga prindërit dhe gjyshërit

e tyre, të shprehura edhe përmes vizatimit dhe pikturës.

Punëtorja “Mbresa” është një program edukativ dhe artistik javor i cili përfshin nxënësit e shkollave të mesme. Programi përmban një konkurs në këto gjini artistike:

1- arte pamore (pikturë, skulpturë, instalacion)

2- krijim letrar (ese, poezi etj),

3- muzikë (melodi, këngë),

4- risi teknologjike etj.

Disa nga objektivat e këtij programi janë: përfshirja, angazhimi, nxitja e të rinjve për të marrë pjesë në aktivitete krijuese/ edukuese, njohja e tyre me regjimin komunist shqiptar, si dhe me veprimtarinë represive të Sigurimit të Shtetit, reflektimi rreth kësaj të kaluarë, promovimi i talenteve të reja, etj.



Nxënësit pasi

vizitojnë muzeun, në bazë të ndjesive të përftuara krijojnë në gjinitë artistike të lartpërmendura. Punimet duhet të dorëzohen në muze brenda 15 ditëve pas vizitës.

Më pas, ato ekspozohen për rreth 2 javë në faqen e facebook-ut të Muzeut dhe krijimi që merr më shumë pëlqime vlerësohet me çmim të veçantë. Një juri e përbërë nga specialistë të fushës vlerëson punimet më të mira. Është parashikuar që krijimet më të mira të vlerësohen me një dhuratë simbolike si dhe të bëhen pjesë e një katalogu.

Programi:

SHKOLLA E MESME “SAMI FRASHËRI”

Data: 03.11.2023

Ora: 11:00

SHKOLLA E MESME “BESNIK SYKJA”

Data: 10.11.2023

Ora: 11:00

SHKOLLA E MESME “PETRO NINI LUARASI”

Data: 17.11.2023

Ora: 11:00

Vendi: Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe”

DITA E ARBËRESHËVE & SAMITI I DIASPORËS

Data: 22-23.11.2023

Vendi: Pallati i Kongreseve

Në datat 22 dhe 23 nëntor do të zhvillohet në Tiranë Dita e Arbëreshëve dhe Samiti i Diasporës. Përgjatë ditës së

parë, personalitete të komunitetit arbëresh dhe studiues shqiptarë do të bëhen pjesë e disa panelesh diskutimi, ku do të diskutohet mbi gjuhën arbëreshe, besimin, bashkëpunimin mes komunave arbëreshe dhe bashkive shqiptare etj. Do të ketë panaire, ekspozita, momente artistike etj. Kjo ditë do të përmbyllet me një koncert gala, ku do të ndahen 10 trofe për 10 personalitete shqiptare në diasporë dhe komunitetin arbëresh.

Në datën 23 nëntor do të zhvillohet edicioni III i Samitit të Diasporës, gjatë të cilit do të flitet për urat e ngritura në diplomaci, ekonomi, kulturë etj.



“TAKIM ME AUTORIN”

Data: 02.11.2023

Ora: 18:00

Vendi: Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit në bashkëpunim me shtëpinë botuese “Toena” organizon një takim me shkrimtarin e ri nga Maqedonia e Veriut, Ivan Dodovski.

PROMOVIM AUTORI

Data: 09.11.2023

Ora: 11:00

Vendi: Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit në bashkëpunim me kryeredaktoren e Albania Letteraria organizon një takim për promovimin e dy autorëve të rinj të diasporës në Itali: Betina Hamzaj dhe Endri Qenanaj.

PROMOVIM LIBRI

Data: 06.11.2023

Ora: 18:00

Vendi: Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit organizon një takim për të promovuar librin “Kryevepra të pakryera” nga autori Bashkim Shehu.

PREZANTIM LIBRI


Oraeligë dhe Flama
Tom Kuka

Data: 07.11.2023

Ora: 18.30

Vendi: Biblioteca dell’IIC
Tirana

Instituti Italian i Kulturës në bashkëpunim me Albania Letteraria, ka kënaqësinë të prezantojë përkthimet në italisht të romaneve Oraeligë dhe Flama, publikuar nga Besa Muci, të autorit Tom Kuka.





PANAIRI I LIBRIT

Edicioni XXVI

Data: 15-19.11.2023

Vendi: Pallati i Kongreseve

Panairi i Tiranës, i vetmi që mbledh të gjitha ngjarjet më interesante të librit gjatë një viti, rikthehet në datat 15-19 nëntor 2023.

Do të jenë ditë të mbushura me aktivitete: ekspozim, prezantime, takime me autorë, shkrimtarë të huaj të ftuar, libra të rinj, çmimet e panairit, konferenca etj.

“TRADUKI NË PANAIRIN E TIRANËS”

Data: 15.11.2023

Ora: 16:00

Vendi: Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit në bashkëpunim me Shoqatën e Botuesve Shqiptarë organizon një takim të rrjetit “Traduki” në mjediset e Panairit të Tiranës, për të diskutuar rreth përkthimit të letërsisë ballkanike në gjuhën gjermane.

Në këtë takim do të marrin pjesë autorë shqiptarë, studiues, kritikë dhe përkthyes të njohur.

TAKIMI ME RRJETIN KULTUROR “TRADUKI”

Data: 16.11.2023

Ora: 10:00 – 16:00

Data: 17.11.2023

Ora: 9:00 – 12:30

Vendi: Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit do të presë në mjediset e veta anëtarët, stafin dhe organizatorët e rrjetit “Traduki”, të cilët do të jenë në Tiranë për të realizuar takimin e tyre vjetor.

Në këtë takim pritet të diskutohet rreth rregullave për t’u bërë pjesëmarrës në projekte letrare dhe kulturore, festivalet letrare dhe Panairin e Leipzigit.

“TRYEZË E RRUMBULLAKËT”

Data: 22.11.2023

Ora: 11:00

Vendi: Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit QKLL

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit organizon një tryezë të rrumbullakët me të ftuar studiues, përkthyes dhe gazetarë, për të folur mbi procesin e standardizimit të gjuhës shqipe dhe dinamikën e saj.

“SHQIPËRIA LEXON”

Data: 24.11.2023

Ora: 12:00

Vendi: Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit organizon një takim me nxënësit e shkollës “Iliria”, Fushë-Krujë, ku do të diskutohet për artin e shkruar, atë letrar dhe joletrar, pasionin për letërsinë dhe rilindësit shqiptarë.

“GJYSHJA IME PERFEKTE”

Teatri Kombëtar Eksperimental
“Kujtim Spahivogli”

Data: 02-05.11.2023

Ora: 10:30

Data: 09 – 12.11.2023

Ora: 10:30

Data: 16– 19.11.2023

Ora: 10:30

Data: 30.11.2023

Ora: 10:30

Vendi: Salla 150, Arturbina Tiranë

Me tekst dhe regji nga: Endri Çela

E kastin e aktorëve: Kleard Gërmenji, Adriana Tolka

Video graphic designer: Renato Aliçkollli

Muzika: Florjan Hoxha

Koreografia: Aledia Kondaj

Kostumografia: Sofi Kara

Skenografia: Beqo Nanaj

Video Shot: Marjo Cani



Ndriçimi: Taulant Kotorri
As.regjisor: Joan Mezini

Shfaqje për fëmijë - Shumë vite më vonë, saktësisht në 2137, në katin e 55-të të një kulle në Tirana City, jeton një djalë i vogël, me emrin 03. Ai jeton me dy prindërit e tij, me dy vëllezërit binjakë çamarrokë dhe me një gjyshe tipike shqiptare, 136-vjeçare. Çdo gjë duket e zakonshme, por, kur prindërit biznesmenë ikin në punë dhe dy vëllezërit e kanë “luksin” të shkojnë në “Hi Tech Colleague” - se janë 2 dhe 3 minuta më të mëdhenj se ai - protagonistit tonë i duhet të rrijë mbyllur në shtëpi, nën kujdesin e gjyshes që mezi dëgjon, mezi shikon dhe mezi merret vesh kur flet. Tepër i bezdisur nga gjyshja 136-vjeçare, ai u kërkon ndihmë vëllezërve dhe, nëpërmjet një çipi që ia vendosi gjyshes në tru, ata fillojnë ta komandojnë dhe ta transformojnë gjyshen si të duan.

“ROSAKU I SHËMTUAR”

Shfaqje teatrale me kukulla për fëmijë
Teatri i kukullave

Data: 04, 05.11.2023

Ora: 10:30, 11:30

Vendi: Salla “Tonin Harapi”, Liceu artistik “Jordan Misja”

Regjia: Paolo Comentale

Aktorët: Esmeralda Kame, Aleksandër Grami, Ermonela Alikaj, Ilija Kaçi, Albana Koçaj, Elidon Alikaj, Madi Selimi.

Kohëzgjatja: 45 min



“E KA KUSH E KA-MOS U NXEH”

Data: 08.11.2023

Ora: 10:00

Vendi: Muzeu Historik Kombëtar

Të njohim trashëgiminë kulturore nëpërmjet lojës “Mos u nxeh”. Pjesëmarrës janë nxënësit e shkollës “Hoxha Tahsim”, Tiranë.

“MAÇOKU ME ÇIZME”

Shfaqje teatrale me kukulla për fëmijë
Teatri i kukullave

Data: 11-12.11.2023

Ora: 10:30, 11:30

Vendi: Salla “Tonin Harapi”, Liceu artistik “Jordan Misja”

Regjia: Paolo Comentale

Aktorët: Esmeralda Kame, Aleksandër Grami, Ermonela Alikaj, Ilija Kaçi, Albana Koçaj, Elidon Alikaj, Madi Selimi.

Kohëzgjatja: 45 min

“E BIJA E HËNËS DHE DIELLIT”

Shfaqje teatrale me kukulla

Premierë

Teatri i Kukullave

Data: 17.11.2023

Ora: 10:00

Vendi: Qendra “Kristal Center”

Data: 18.11.2023

Ora: 10:30, 11:30

Data: 19.11.2023

Ora: 10:30, 11:30

Data: 25.11.2023

Ora: 10:30, 11:30

Vendi: Salla “Tonin Harapi”, Liceu artistik “Jordan Misja”, Tiranë

Regjia: Ina Morinaj

Aktorët: Aleksandër Grami, Ilia Kaçi, Elidon Alika, Ermonela Alika, Madi Selimi.

“EKSPOZITË PIKTURE”

Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë

Data: 17.11.2023

Ora: 11:00

Vendi: Kalaja e Tiranës

Në kuadër të festës së çlirimit të Tiranës, me pjesëmarrjen e fëmijëve të kursit të pikturës të QKKF-së do të hapet një ekspozitë mbi këtë temë.

“NUMRA REPERTORI”

Shfaqje Cirku Kombëtar

Data: 08.11.2023

Ora: 12:00

Kamzë, Qendra Kulturore

Data: 17.11.2023

Ora: 12:00

Vendi: Shesh, Tiranë

Data: 22.11.2023

Ora: 12:00

Vendi: Teatri “A. Moisiu”, Durrës



Data: 28- 29.11.2023

Ora: 12:00

Vendi: Tiranë

“TALENTI NUK NJEH BARRIERA”

Data: 20.11.2023

Ora: 18:00

Vendi: TKOBAP, skenë

Aktivitet i mbështetur nga Ministria e Kulturës. Koncerti u dedikohet fëmijëve me aftësi ndryshe

Klubi Kombëtar i Fëmijëve me CSA

“EKSPOZITË PIKTURE”

Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë

Data: 27.11.2023

Ora: 17:00

Vendi: Muzeu Historik Kombëtar

Në kuadër të Festave të Nëntorit, me pjesëmarrjen e nxënësve të kursit të skenografisë/kostumografisë të QKKF-së do të hapet një ekspozitë pikturë, me tematikë nga këto data të shënuara.

“KONCERT FESTIV”

Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë

Data: 28.11.2023

Ora: 11:00

Vendi: Qendra “Kristal Center”

Koncert festiv “Ngjyrat e nëntorit”, me pjesëmarrjen e fëmijëve të QKKF-së, që do të zhvillojnë shfaqjen teatrale “Kryezoti i Arbërisë”. Marrin pjesë nxënësit e kursit të aktrimit. Po ashtu do të ketë valle dhe këngë popullore nga fëmijët e kursit të valleve dhe këngës.

“NËNTORI FESTIV”

Data: 24.11.2023

Ora: 10:00

Vendi: Muzeu Historik Kombëtar

Në kuadër të Festave të Nëntorit do të zhvillohet aktivitet me interpretime dhe valle me nxënësit e gjimnazit “Besnik Sykja”, Tiranë.